











MODEL PLANIFIKIMI DITOR Klasa VII

Data: _____

FUSHA: Shkencat e natyrës	LËNDA: Biologji	Shkalla: III	Klasa: VII
<p>TEMAT MËSIMORE 15-16:</p> <p> Ora e parë: - Zinxhirët ushqimorë</p> <p> Ora e dytë: -V.P. Të ndërtojmë zinxhirë ushqimorë..</p>		<p>SITUATA E TE NXËNIT: Gjallesat ndërveprojnë me njëra tjetrën-Ato hanë dhe hahen nga të tjerat. Ndërtimi i zinxhirëve ushqimorë.</p> <p>Situata e të nxënit -Video javascript:playVideo(1,'Cd1M9xD482s') javascript:playVideo(2,'KI7u_pcfAQE') javascript:playVideo(1,'Q6a7pb5cYëY') javascript:playVideo(3,'LVJ5BKcAhAg') javascript:playVideo(2,'ELkXmS0PtU0') javascript:playVideo(5,'33pC31rë9bM')</p>	
<p>REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE TË FUSHËS SIPAS TEMËS MËSIMORE:</p> <p>Rezultatet për njësinë mësimore 1</p> <ul style="list-style-type: none">  Identifikon prodhuesit dhe konsumatorët në një zinxhir ushqimor.  Ndërton të paktën 3 zinxhirë ushqimorë ujorë dhe tre tokësorë me nga tre konsumatorë.  Analizon rolin që kanë gjallesat në një zinxhir ushqimor në uajtjen e homeostazës në një ekosistem. <p>Rezultatet e të nxënit për njësinë mësimore 2</p> <ul style="list-style-type: none">  Shkruan 4 zinxhirë ushqimorë ujorë dhe tokësor  Analizon se burimi i energjisë në rruzullin tokësor është dielli energjia e të cilit përthithet nga organizmat fotosintetikë (bimët) të cilat janë baza e një zinxhiri ushqimor e më pas transferohet nga hallka paraardhëse në atë pasardhëse.  Përcakton dallimet midis një rrjete ushqimore dhe një zinxhiri ushqimor.  Organizon referuar menuve të ndryshme ushqimore që përdorin gjallesat lidhje ushqimore.  Vlerëson rëndësinë që ka secila gjallesë në zinxhir ushqimorë si dhe dekompozuesit në ruajtjen e homeostazës së një ekosistemi. 		<p>FJALËT KYÇE Prodhues, lidhje ushqimore, konsumatorë, organizma autotrofë (fotosintetikë), konsumatorë, dekompozues, rrjetë ushqimore, menu ushqimore,homeostazë, organizma heterotrofë, energji, biomasë, fitoplankton, zooplankton, Bimëngrënës, mishngrënës, etj..</p>	
<p>BURIMET: Video mbi zinxhirët ushqimorë, markera, format A4, foto të ndryshme (bimësh, kafshësh, frutash, farash), cd, kompjuter, projektor, plastelinë, tabela biologjie (Lidhjet ushqimore dhe rrjetat ushqimore), atlas i biologjisë, kartona, etiketa, kafshë të ndryshme lodër, mokete, etj..</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Kiminë, Matematikën, Gjuhët dhe komunikimin, arte,;</p>	
<p>METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE -</p> <p>A) <i>Metoda eksperimentale, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse, hulumtuese.</i></p> <p>Grupet e ekspertëve - <u>Koha 15 minuta</u></p> <p>Nxënësve u shfaqen foto të kafshëve me projektor në tabelë dhe u kërkohet ti emërtojnë ato si dhe të listojnë nga dy-tre specifika për secilën.</p> <p>Shfaqen në monitor video (Situata e të nxënit)</p>			



Përshkrimi i situatës

Koncepti që kërkohet të merret nëpërmjet pyetjeve është nga ana e mësueses është: Mënyra e ushqyerjes së këtyre gjallesave.

Kërkohet që nxënësit të përcaktojnë nëse ndonjëra prej tyre ushqehet me bimë.

Nxënësit vihen të lexojnë tekstin për **10 minuta** dhe nën udhëheqjen e mësueses.

Shfaqen video mbi ndërveprimin e gjallesave me njëra-tjetrën në mjedis (komente nga nxënësit), udhëzohen që të mbajnë shënime konceptet që trajtohen pasi mbi to do të ndërtohet mësimi.

Veprimet në situatë: - Koha 20 min.

Puna me nxënësit-Të nxënë të bashkëpunim (mësues/nxënës-ndërtojnë dijen)

Mësues-i/ja rendit konceptet kyç në tabelë dhe pasi merr një feedback nga nxënësit shpjegon termat me kujdes duke u bërë i qartë dallimin konceptual midis tyre:



Zinxhirë ushqimorë

Prodhuës

Konsumatorë

Mishngrënës

Heterotrofë



Më pas nxënës-it/ve pasi u janë vënë në dispozicion termat nga mësues-i/ja në tabelë jo vetëm për konceptet por edhe mbi lidhjet ushqimore, nxënësit fillojnë të informacion në lidhje me lidhjet ushqimore. Nxënësit punojnë **parashikim me terma paraprakë** me termat e vendosura në tabelë duke treguar nga një emër kafshë e cila të ushqehet me bimë, me mish, dhe të shpërbëjë lëndën organike të vdekur.

Nxënësve u shpjegohet nga një shembull zinxhiri ushqimor ujqor dhe tokësorë, theksohet se zinxhiri ushqimor gjithmonë fillon me bimët pasi ato janë të vetmet gjallesa të cilat kapin energjinë diellore duke e shndërruar atë në energjinë e biomasës e më pas ta transferojnë nëpërmjet zinxhirëve ushqimorë pasardhës.

Zinxhir ushqimor tokësor

Fara → zog → gjarpër → skifter → bakterie
P K1 K2 K3 K4

Zinxhir ushqimor ujqor

fitoplankton → zooplankton → peshk i vogël → peshk i madh → njeriu
P K1 K2 K3 K4

Vendoset theksi në dallimin midis një zinxhiri ushqimor dhe një rrjete ushqimore (shoqërohet edhe me video)

PJESA E DYTË E ORËS - 45 MINUTA

Veprimtari praktike me nxënësit - 15 MINUTA

Nxënësve u vihen në dispozicion foto, atlase, tabela, fletë formati, markera, etiketa, dhe u kërkohet të ndërtojnë nga 4 zinxhirë ushqimorë me figurat që kanë mbi bangë .

U kërkohet të përcaktojnë elementët përbërës të zinxhirit ushqimor dhe të shpjegojnë rolin që zë secili në të. Shfaqet një film mbi homeostazën në ekosistem, ku gjallesat hanë dhe hahen nga të tjerat, nxënësve u kërkohet të argumentojnë e diskutojnë me njëri-tjetrin në çift.

- Lojë me role - KOHA 10 MIN.

Nxënësit interpretojnë në lojë me role elementët përbërës të një zinxhiri ushqimor (duke u vendosur vetë në hallkat e zinxhirit ushqimor).

Diskutim dhe përforsim i koncepteve gjatë gjithë orës.

Punë e diferencuar në klasë - Përvijimi i koncepteve - KOHA 20 MINUTA

Nxënësit punojnë pjesën e punës praktike të pavarur në tekst

Nx. u krahasojnë mendimet e tyre me njëri-tjetrin:

Nxënësit punojnë me teksin dhe analizojnë konceptet kyç të temës mësimore.

Nxënësit punojnë të pavarur veprimtarinë praktike mbi ndërtimin e zinxhirëve ushqimorë nën udhëheqjen e mësueses dhe u përgjigjen pyetjeve në fund të pjesës së punës praktike.

Punohet me librin e nxënësit si dhe me librin e ushtrimeve dhe i përgjigjemi pyetjeve të tekstit si dhe atyre të përgatitura nga mësuesja:

Vlerësimi:

- Vlerësimi për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin në punën në grup;
- Saktësinë në zgjidhjen e ushtrimeve;
- Aftësinë dhe gjuhën e komunikimit;

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie:

Analizoni rolin pozitiv të grabitqarëve në një zinxhir ushqimor.

Krijoni tre zinxhirë ushqimore në të cilën të paktën njëra prej gjallesave të përdoret me menu të ndryshme ushqimore.